

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Regjistruan 1143 hektarë me dokumente false/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pran ga edhe një punonjës (EMRAT)
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/regjistruan-1143-hektare-me-dokumente-fals-arrestohen-dy-ish-drejtore-i514591
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:39:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:31:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8998acbec13c93464c106bc9aec5acd1fa024ffa18a6f4b68910e910c839fca7
TEKSTI	bc04fe7c5b5f6ea7dc1d1674152d87cc287f7304515d9ac4c32bb8ae4744032f
PAMJA	c124348b2d4c748f48313638b2fcc73903a39f76547f893b6768c6535337fcf2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ec61e4ec2f4c2362796a321cdbd10e1f34702fb4f20fdea2cc919d044d5d0d1a
E MËPARSHMJA	44553015e509b3ce1460b722fe7327326b467085faf3d630ef26f79b6505e6f1
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ec61e4ec2f4c2362796a321cdbd10e1f34702fb4f20fdea2cc919d044d5d0d1a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

11 ORE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

16 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxit protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

21 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Rama shkon në Kuvend. Bardhi: Puç kushtetues

21 ORE ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

Aktualitet

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente false/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, gjykata ka caktuar masën e sigurimit personal "Arrest në burg" për ish-kreun e Kadastrës Ertis Shehu, biznesmenin Kastriot Hasko dhe dy persona të tjerë me initiale B.K. dhe PÇ.



17 Shtator 2026, 10:31
Nga I.A



FIER- Katër persona janë arrestuar me kërkesë të Prokurorisë së Fierit, në kuadër të një hetimi për falsifikim dokumentesh, shpërdorim detyre dhe pastrim të produkteve të veprës penale. Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, gjykata ka caktuar masën e sigurimit personal "Arrest në burg" për ish-kreun e Kadastrës Ertis Shehu, biznesmenin Kastriot Hasko dhe dy persona të tjerë me initiale B.K. dhe PÇ.

Dy prej të arrestuarve, Ertis Shehu dhe B.K., kanë mbajtur më herët detyrën e drejtorit të ASHK-së Fier, ndërsa P.Ç. ka qenë specialist dhe jurist pranë këtij institucioni. Biznesmeni Kastriot Hasko dyshohet se është përfituesi i pronave objekt hetimi. Në kuadër të hetimeve janë sekuestruar mbi 76 pasuri, me një sipërfaqe totale prej 1143 hektarësh tokë, si dhe 150 mijë euro. Pasuritë ndodhen në zonat kadastrale 3301 dhe 3358, në Seman të Ri dhe Sheq Marinas, Fier.

Njoftimi i Prokurorisë:

Arrestohen me kërkesë të Prokurorisë Fier për falsifikim dokumentesh e shpërdorim detyre, dy ish-drejtorë të ASHK-së, specialisti dhe përfituesi i pronës, sekuestrohen 1143 ha tokë Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier u vendos masa e sigurimit personal 'Arrest në burg' ndaj katër shtetasve E.Sh., B.K. në cilësinë e drejtorëve të ASHK, P. Ç. specialistit, jurist, pranë ASHK dhe K.H., përfituesi i pronave nën akuzë për veprat penale 'Falsifikim i dokumenteve', 'Shpërdorimi i detyrës' si dhe 'Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale' të parashikuara nga nenet 186/2, 248 dhe 287, prg.2, të Kodit Penal.

editoriale

Irena Begiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:12

"Taksë e fshehtë" mbi naftën
për rezervën e sigurisë, do të
rritet çmimi, e pranon dhe
qeveria

AKTUALITET 17 SHTATOR 2026, 22:14

Sherri mes të rinjve në
Sarandë/ Dalin PAMJET nga
vendi i ngjarjes, njëri prej
autorëve tenton t'i ngulë
thikën në qafë...

Po kështu, në kuadër të hetimeve u sekuestruan mbi 76 pasuri, me sipërfaqe totale prej 1143 hektarë tokë (e barabartë me njëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e gjashtë m2), si dhe 150.000 euro.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier gjatë hetimeve të deritanishme për procedimin penal nr. 1026 të vitit 2025, kryer në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, nëpërmjet përdorimit edhe të metodave proaktive, arriti të provojë se:

Shtetasi K.H., duke paraqitur si tituj pronësie dy vendime të falsifikuara të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier, ka arritur të regjistrojë në bashkëpronësi të tij dhe katër personave të tjerë një sipërfaqe të konsiderueshme toke prej 1,143 hektarë si dhe 150.000 Euro të ndodhur në zonat kadastrale 3301 dhe 3358, Seman i Ri dhe Sheq Marinas, Fier.

Më pas, ky shtetas, duke u paraqitur me cilësinë e bashkëpronarit dhe përfaqësuesit edhe të bashkëpronarëve të tjerë, me anë të një prokure të posaçme të falsifikuar, u ka shitur këtë tokë dy shoqërive të ndryshme.

Shtetasit E.SH. dhe B.K., në cilësinë e drejtorëve të ASHK, Fier, dhe shtetasi P.Ç., në cilësinë e specialistit, jurist, pranë ASHK, Fier, kanë regjistruar pasuritë në fjalë në bashkëpronësi të shtetasit K.H., në kundërshtim me ligjin nr. 111/2018, "Për kadastrën", dhe ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe VKM nr. 639, datë 16.10.2024, dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit", duke mos kërkuar sipas këtyre akteve ligjore/nënligjore konfirmimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, verifikim nga i cili do të rezultonte se këto vendime janë të falsifikuara.

Për më tepër, ka rezultuar se shtetasi B. K., ish drejtor i ASHK, Fier, kur ka regjistruar pasurinë nr. 3***, zk 3358, ka tejkaluar edhe sipërfaqen që sipas vendimit të falsifikuar nr. 8*, datë 20.01.1997, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë Këshillit të Rrethit Fier, i ishte kthyer ish-pronarit Th.S., duke përfutur për rrjedhojë shtetasi K.H. edhe një sipërfaqe tjetër të konsiderueshme toke në pronësi. Gjithashtu, shtetasit E.SH. e P.Ç. gjatë regjistrimit të pasurive kanë ndryshuar zërin kadastral të sipërfaqes së regjistruar në pronësi të shtetasve K.H., etj, nga tokë arë në tokë pa frut, pa një akt administrativ nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë apo Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier. Masat e sigurimit personal dhe pasuror u ekzekutuan nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier në bashkëpunim me shërbimet e Komisarit të Policisë Nr. 2 dhe Nr. 3 Tiranë, si dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë./Dosja.al

ertis shehu

kastriot hasko

Sondazh

Poll

Aktualitet

17 Shtator 2026, 09:59

Nis dita e 110 e revoltës/ Një grup protestuesish mbledhen pranë SPAK: Lironi çunat (VIDEO)

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 20:56

Rastësi apo? Ditën që u shpallën fajtor ish-krerët e UÇK-së, Rama viziton Manastrin me lidhje serbe në Malin Athos

më të klikuarat

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente false/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm ‘Marbella’/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Pamje TIRANA- Një grup protestuesish janë mbledhur para ambienteve të SPAK, ndërsa kanë thirrur njëzëri "Liro...

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

Aktualitet

17 Shtator 2026, 09:47

VIDEO/ Plagosi ish-vjehrrin me drapër, del para gjykatës së Fierit daja i deputetes socialiste Zegjine Çaushti

Aktualitet

17 Shtator 2026, 09:26

VIDEO/ Protesta para Kuvendit, polica bllokoi me gardh metalik zonën

Aktualitet

17 Shtator 2026, 09:12

Sot seancë plenare në Kuvend/ Qytetarët protestojnë para godinës: Rama jep dorëheqjen!

Aktualitet

17 Shtator 2026, 09:02

Aktualitet

17 Shtator 2026, 08:44

Plagosja e trefishtë në Sarandë/ Dy vëllezër mes të plagosurve, arrestohen dy persona dhe shpallet në kërkim një tjetër (EMRAT)

Foto ilustruese SARANDA- Detaje të reja janë zbuluar nga plagosja e trefishtë e cili ndodhi mbrëmjen e shkuar pranë shëtitores...

"Ju erdhi fundi"/ Sot dita e 110-të e

protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

Aktualitet
17 Shtator 2020, 08:30

Plagosen me thikë tre persona pranë shëtitores në Sarandë, policia nis hetimet

Aktualitet
17 Shtator 2020, 08:23

E rëndë në Tiranë/ Tezja dhe kushëri abuzojnë seksualisht me 12-vjeçaren, në telefonin e saj u zbuluan video të rënda pornografike

Aktualitet
17 Shtator 2020, 08:10

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Prishtina proteston deri në orët e vona, qytetarët hedhin gurë e mjete piroteknike drejt zyrave të EULEX (VIDEO)

Aktualitet
17 Shtator 2020, 07:51

MË SHUMË



Protesta e 110-të kundër qeverisë/ Qytetarët rrethojnë komisariatit nr.1, thirrje: Lironi çunat



Protesta e 110-të kundër qeverisë/ Qytetarët rrethojnë komisariatit nr.1, thirrje: Lironi çunat

Bardhi:Kompania që u kap me41kilogramë kokainë, përfitojë nga Qeveria1million euro nga fondet e IPARD

Diskutimet për pagat e magjistratëve, kryeministri Edi Rama i bashkohet seancës në Kuvend

Marshim i protestuesve/ Policia bllokoi hyrjet që të çojnë drejt Kuvendit

Protesta e 110-të kundër qeverisë/ Qytetarët rrethojnë komisariatit nr.1, thirrje: Lironi çunat

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zëvendësuar rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë deri të

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI

Drejtor: Enton Abilekaj
Kryeredaktor: Izmir Akulli

qenë të besueshëm. Dosja.ai do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MUNDËSHKAR NGA  Mediodesk

ENVIRONMENT

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.